



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 74-të të mbajtur më 05.09.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i dorëzuar me numër 12-838/1, të datës 23.02.2021, kundër përmbauesit, gjyqtarit të Gjykatës Themelore dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, **HIDHET POSHTË.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, sepse vlerësoi se kompetent për të vepruar janë organet tjera.

Denoncimi të dorëzohet në veprim kompetent Këshillit Gjyqësorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lënda me numër 12-838/1 të datës 23.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 23.02.2021, është bërë kallëzim kundër -----
----- përmbaues, ----- gjyqtar i Gjykatës Themelore -----,
-----, ----- dhe ----- gjyqtarët e Gjykatës së Apelit -----
-- dhe është themeluar lënda me nr.12-838/1, të datës 23.02.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se nga përmbauesi i njoftuar në procedurën e përmbaimit janë ndërmarrë një sërë paligjshmërisë me qëllim të ----- të përfitojë përfitim të paarsyeshëm në shumë prej 1.023.907,00 denarë, në dëm të kreditorëve të tjerë të cilët është dashur të përfitojnë nga shitja e paluajtshmërisë që i nënshtrohet përmbaimit. Përmbauesi i denoncuar nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit për përmbaimit, gjegjësisht nuk e ka refuzuar kërkesën për përmbaimit përkundër faktit se për të njëjtin dokument përmbaimit ka qenë në procedurë me një përmbaues tjetër. E pakënaqur me veprimet e përmbauesit të njoftuar, parashtruesi ka paraqitur kundërshtim kundër urdhrin të përmbaimit. Gjyqtari i denoncuar i Gjykatës Themelore ---
----- e refuzoi kundërshtimin si të pabazuar dhe pas ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës

Themelore ----- - Gjyqtarët e denoncuar të Gjykatës së Apelit ----- kanë nxjerrë aktvendim me të cilin refuzohet ankesa si e pabazuar. Për shkak të sjelljes së përmendur, parashtruesi shpreh dyshime se bëhet fjalë për sjellje kriminale, të njëanshme dhe korruptive të personave të denoncuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se denoncimi ka të bëjë me pretendime që nuk janë objekt i veprimit kompetent të KSHPK-së, por janë pretendime që kanë të bëjnë me një çështje që lidhet me veprimin kompetent të një autoriteti tjetër kompetent, në veçanti Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është kompetent që të veprojë mbi parashtrësit dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave dhe Odës së Përmbaaruesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. në lidhje me trajtimin e pabarabartë të përmbaaruesve.

Nga aty, KSHPK-ja konsideroi se nuk ka kompetencë të veprojë në rastin në fjalë, dhe denoncimin për veprim kompetent do ta dorëzojë në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Dhomën e Përmbaaruesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska